

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Mirvete Alidemi, në çështjen kontestimore të paditëses D.Xh. nga Gjilani, Rr." ... ", të cilën sipas autorizimit e përfaqëson S.Z., avokat nga Gjilani, e paraqitur ndaj të paditurit B.E. nga Gjilani, lagja " ... ", Rr." ... ", pa nr, për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, më dt. 28 Maj 2018, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Në bazë të pohimit

APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses D.Xh. nga Gjilani, e paraqitur ndaj të paditurit Xh.Sh. nga Gjilani, për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë, dhe

- I. **VËRTETOHET** se paditësja D.Xh. nga Gjilani, në bazë të shitblerjes është pronare e ngastrës kadastrale ... ZK ..., e cila gjendet në vendin e quajtur " ... ", në sipërfaqe prej 977m², e evidentuar sipas certifikatës pronësore në emër të B.E. nga Gjilani.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

1. Jurisdiksioni dhe kompetenca e gjykatës.

1.1 Jurisdiksioni i gjykatës është përcaktuar konform nenit 11.1 të Ligjit për Gjykatat i Kosovës, kurse kompetenca lëndore është përcaktuar konform nenit 29 të LPK-së, kurse kompetenca territoriale është përcaktuar konform neni 41 të LPK-së, si kompetencë territoriale ekskluzive në bazë të vendit ku gjendet paluajtshmëria.

2. Rrjedha e procedurës.

2.1. Paditësja fillimisht në këtë gjykatë ka paraqitur padi ndaj të paditurit Xh.Sh. nga Gjilani, për vërtetimin e të drejtës së pronësisë.

2.2. Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 12.12.2017, paditësi i tretë ka hequr dorë nga pjesa e tij e trashëgimisë për pjesën ideale të ngastrës kadastrale ...ZK Partesh, në dobi të dy paditësve tjerë.

2.3. Përfaqësuesi i paditëses me parashtresën e dt.07.11.2017, ka bërë precizimin e padisë në kuptimin subjektiv ashtu që në vend të palës së paditur Xh.Sh. e ka paditur B.E. nga Gjilani, me të cilën ka kërkuar vërtetimin e pronësisë në njësinë kadastrale ... ZK Gjilan, në vendin e quajtur " ... ", në sipërfaqe prej 977 m², qka paditësja në vitet e 90-ta e kishte blerë këtë paluajtshmëri edhe të cilën e posedon pa asnjë shqetësim nga askush.

2.4 I padituri B.E. nga Gjilani, në deklaratën e tij nën betim të dhënë para noterit ka deklaruar se ai një pjesë të parcelës ... ZK Gjilan, në sipërfaqe prej 1000 m², në vendin e quajtur " ... ", i'a kishte shitur tani paditëses dhe ishte përmbushur detyrimi nga ana e blerëses tani paditësja D.Xh.. Shitja e kësaj parcele

ishte bërë në fund të vitit 1999 dhe fillimi i vitit 2000, dhe ka deklaruar se ai nuk asnjë lloj kërkesë të tanishme apo në të ardhmen.

2.5 Gjykata pas analizimit të pretendimeve të paditëses të paraqitura në padi dhe provat materiale të bashkangjitura padisë si dhe pohimit të kërkesëpadisë nga ana e të paditurit, ka konstatuar se ngastra kadastrale nr. ... ZK Gjilan, me sipërfaqe prej 977 m², e cila sipas certifikatës së pronësisë të datës 07.11.2017, evidentohet në emër të të paditurit B.E. nga Gjilani.

2.6 Po ashtu, gjykata konstaton se ngastra kadastrale ..., në sipërfaqe të tërsishme prej 17623 m², evidentohet në emër të B.E. dhe se një pjesë e kësaj ngastre kadastrale në sipërfaqe prej 977 m², e cila tash evidentohet me nr. ..., ishte blerë nga paditësja D.Xh. dhe se prej viteve të 90 e njëjta këtë ngastër e shfrytëzon pa u penguar nga askush dhe senë këtë ngastër ka të ndërtuar shtëpinë.

2.7 Me këtë gjykata ka konstatuar edhe legjitimitetin real pasiv të palëve në kontest, si dhe të drejtat që janë objekt i këtij raporti civilo-juridik janë në disponimin e të drejtave të palëve, prandaj edhe ka aprovuar kërkesën e paditëses dhe pohimin e kësaj kërkesë nga ana e të paditurit, në bazë të nenit 148 të LPK-së, respektivisht ka marrë Aktgjykim në Bazë të Pohimit.

2.8 Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në bazë të nenit 452 par. 4 të LPK.

2.9 Nga arsyet e theksuara më lartë, e bazuar në nenin 143 dhe 148 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

G j y k a t ë s j a

Mirvete Alidemi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të të njëjtit, vetëm për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplarë përmes kësaj gjykate.